



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
KURBIN**

**Nr. rregj.them.146
Date.08.02.2005**

**Nr. 82 vendimi
Date .22.02.2005**

**VENDIM
« NE EMER TE REPUBLIKES »**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin e perbere nga :

Enton Dhimitri - GJYQTAR

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Davida Jushi**, sot me dt.22.02.2005, perfundoi se shqyrtuara ne seance gjyqësore publike çeshtjen civile me Nr.146 regj.them. qe i perket :

K E R K U E S : Marjana Gjeloshi ,e bija e Rrokut dhe e Lukes e dtl.07.05.1973, lindur ne Shkoder e banuese ne Fush Kuqe , e ve , me arsim te mesem, me shtetsi e kombesi Shqiptare, perfaqesuar ne gjykim me deklarim ne seance nga av. Pal Metaj.

O B J E K T I : Leshimin e deshmise se trashegimise ligjore .

BAZA LIGJORE : Neni 348,360 e vijues i Kodit Civil,neni 388 I K.pr.Civile.

Gjykata pasi degjoi shpjegimet e e kerkueses rreth faktit objekt Gjykimi ,mori provat e paraqitura prej saj,gjate shqyrtimit gjyqësor ne perfundim te te cilit , ajo kerkoi pranimin e kerkeses.

VEREN

Se kerkuesja i eshte drejtuar Gjykates me kerkeses per leshimin e deshmise se trashegimise per te ndjerin Kol Gjeloshi

Gjykata çmon se kerkuesja ka interes per nje kerkim te tille , si ish bashkeshortja e te ndjerit Kol Gjeloſhi, e provuar kjo me ane te certifikates se marteses Nr.15-39 date 01.02.2003.

Nga shqyrtimi gjyqsore rezultoi e provuar me ane te certifikates se vdekjes Nr.34-75 date 31.01.2005 se me dt.20.05.2003 ka vdekur Kol Gjeloſhi , bashkeshorti i kerkueses.

Ne baze te nenit 318 te K.Civil , ligji qe do te zbatohet per marredhenien e trashegimise ne fjale eshte ligji 7850 date 29.07.1994 "Per Kodin Civil te Republikes se Shqiperise"i cili rezulton te jete ligje ne fuqi ne kohen e vdekjes se trashegimlensit .

Duke iu referuar **nenit 360** te ketij ligji rezultoi e provuar me ane te certifikates se perberjes familjare Nr.15-39 date 31.12.2005 ,çertifikates se lindjes Nr.15-39date.31.01.2005 e shtetases Marjana Gjeloſhi tashegimtare ligjore te radhes se pare jane:

- Marjana Gjeloſhi bashkeshortja
- Rajmonda Gjeloſhi e bija
- Mira Gjeloſhi e bija
- Klevis Gjeloſhi I biri

Te cilet jane qe te gjithe gjalle .

Gjithashtu nga shqyrtimi ne séance gjyqesore nuk rezultoi qe trashegimlensit te kete lene testament , te kete patur femije jashte martese, apo te biresuar,apo ndonjeri prej trashegimtareve te kete hequr dore nga trashegimia ,te jete perjashtuar ose te jete deklaruar I padenje .

Ne keto kushte celet trashegimia ligjore per trashegimlensin Kol Gjeloſhi,duke percaktuar si trashegimtare ligjor te radhes se pare ,shtetasit:Marjana Gjeloſhi,Rajmonda Gjeloſhi,Mira Gjeloſhi e Klevis Gjeloſhi .

Ne kuptim te **nenit 361** te K.Civil. ato trashegojne 1/4 pjese te pasurise luajtshme dhe te paluajtshme kudo qe ajo ndodhet.


Persa dhe si u arsyetua me siper Gjykata çmon se kerkesa eshte e bazuar ne prova e ne ligje dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar ne nenin 348,360 e vijues te K.Civil. dhe 388 te K.Pr.Civile.

VENDOSI

Pranimin e kerkeses se kerkueses.





Leshimin e deshmise se trashegimise ligjore per te ndjerin Kol Gjeloshi, duke percaktuar si trashegimtar ligjor te radhes se pare shtetasit:

- Marjana Gjeloshi
- Rajmonda Gjeloshi
- Mira Gjeloshi
- Klevis Gjeloshi

te cilet trashegojne 1/4 pjese secili,te pasurise se luajtshme e te palujtshme kudo qe ajo ndodhet.

Trashegimtarët do te pergjigjen per detyrimet ne perputhje me pjesen e pasurise se trasheguar dhe brenda kufirit te kesaj pasurie


Shpenzimet gjyqesore I ngarkohen pales kerkuese.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 diteve nga e nesermja e shpalljes se tij.

U shpall ne Laç, sot me date .22.02.2005.

SEKRETARE

DAVIDA JUSHI



GJYQTARI

ENTON DHIMITRI

